



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI**

---

Numri i lëndës: 2020:184961

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05492566

CPP.nr.22/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit K.U.R “M...” sh.a, me seli në Mitrovicë, kundër debitorit L.H nga Vushtrria, lidhur me çështjen përbarimore Pagimi i Borxhit në shumë prej 813,92 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit, jashtë seance, me datën 22.03.2024 e mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET PJESËRISHT i bazuar prapësimi i debitorit L.H nga Vushtrria ashtu që SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri përbarimor P.nr.3435/20 i datës 24.09.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat A.M në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përkatësisht për 598,42 € për periudhën kohore prej 31.03.2016-31.12.2018 për shkak të parashkrimit, ndërsa MBETET PJESËRISHT NË FUQI Urdhri përbarimor P.nr.3435/20 i datës 24.09.2020, i lejuar nga Përbaruesi Privat A.M në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, për periudhën kohore prej 01.01.2019 - 31.08.2020 për pjesën tjetër në shumë prej 215,50 € ashtu që:

II. OBLIGOHET debitori L.H nga Vushtrria, që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit K.U.R. “M...” sh.a, me seli në Mitrovicë në emër të borxhit për shfrytëzimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për periudhën kohore prej 01.01.2019 - 31.08.2020, t’ia paguaj shumën prej 215,50 €, me kamat ligjor prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përbarim, e deri në pagesën definitive të borxhit.

III. Në rast ankese kundër këtij aktvendimi urdhërohet pala ankuese që konform nenit 78 par.1 të LPP-së paraprakisht të paguaj garancinë në të holla në shumë prej 215,50 €, si parakusht për parashtrimin e ankesës, në të kundërtën, gjykata konform nenit 78 par.4 të LPP-së do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

**A r s y e t i m**

Përbaruesi Privat A.M, në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës si në shkruesat e lëndës per periudhën kohore nga data 31.03.2016 e gjerë me datën 31.08.2020.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësim debitori me të cilin e kundërshton urdhrin përbarimor si të pa bazuar. I njëjti thekson ndër te tjera se kërkesa

e kreditori është parashkruar. Mbi bazën e të lartcekurave, i njëjti kërkon nga gjykata që të aprovoi prapësimin si të bazuar dhe të anuloi urdhrin përmbartimor.

Kundër prapësimit të debitori ka paraqitur përgjigje në prapësim kreditori në të cilin ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, të njëjtit i bashkëngjet historiatin e shpenimeve të debitorit. Thekson se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk ka pranuar fatura për shpenzimet e ujës-jellësit, pasi që nga debitori nuk kanë pranuar asnjëherë një ankesë të tillë. Po ashtu, thekson se lëndës i kanë bashkëngjitur edhe Ekstraktet nga librat e kontabilitetit ku shihet se debitori i ka pranuar faturat, si dhe shihet periudha e borxhit se për cilën kohë është ngarkuar me borxh. Prandaj, i njëjti kërkon nga gjykata që urdhri për përmbartim të mbetet në fuqi, ndërsa kundërshtimet e debitorit të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata pas analizimi dhe vlerësimit të prapësimit të ushtruar nga debitori dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, gjeti se prapësimi i debitorit është Pjesërisht i Bazuar.

Lidhur me pretendimin e debitorit se faturat e prezantuara kanë arritur afatin e parashkrimit, gjykata vlerëson se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, pasi që me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në nenin 360 përcaktohet se: *“afati njëvjeçar i parashkrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë” ndërsa par 2 dhe 3 e kësaj dispozite parasheh se: 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. 3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë, andaj gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës, si dhe periudhës kohore për të cilën është propozuar dhe lejuar përmbartimi, erdhi në përfundim se borxhi i cili ka rrjedhë për periudhën kohore prej dt.31.03.2016-31.12.2018 është i parashkruar, ndërsa që nga data 01.01.2019-31.08.2020 borxhi nuk është i parashkruar dhe për të njëjtin lejohet përmbartimi, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

Gjykata, lidhur me kumatën ligjore, iu referua nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Ndërsa sa i përket afatit të rrjedhjes se kumatëvonesës, gjykata i referohet mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/20, i dt.01.12.2020, respektivisht par. II, III dhe VI të këtij mendimi juridik dhe gjeti se debitori ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit nga data kur është ushtruar propozimi për përmbartim e tutje.

Nga shkaqet e theksuara më lart rezulton se Prapësimi i ushtruar nga debitori është pjesërisht në pajtim me nenin 73 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CPP.nr.22/24, datë: 22.03.2024

Gjyqtari  
Izet Gërguri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.